



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
KORÇE

Nr. 200 Regj. Them
Data e Regj:07.01.2015

Nr.212 Vendimi
Date: 24.04.2015

VENDIM

(NE EMER TE REPUBLIKES)

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe e perbere nga:

SOKOL IBI – Gjyqtar

ne prane te sekretares Marinela Rushi, ne Korçe, sot ne date 24.04.2015,
gjate seances gjyqesore per gjykimin e çeshtjes administrative me nr. 200
Regj.Them. qe i perket:

PADITES: Ramadan Seitllari, i biri i Nasuf dhe i Xhevaire me d.t.l.
16.09.1949, lindur dhe banues ne fshatin Memelisht te
Komunes Udenisht.

I PADITUR: Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe e perfaqesuar ne gjykim
me autorizim nga Mirela Veriga.

OBJEKTI: Shfuqizimin e akt-konstatimit date 23.04.2012 dhe
procesverbal gjobe numer 0028821 dhe akt konstatimi date
24.05.2012 dhe procesverbal gjobe numer 0028829 te
Drejtorise Rajonale te Tatimeve Korçe.

BAZA LIGJORE: Neni 17 i ligjit Nr.49/2012, ligji Nr.9920, date
19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e
Shqiperise”.

KONSTATON

Se pala paditese ka praqitur para gjykates padine me objektin e sipercituar.

Ne daten 23.04.2012 inspektoret e pales se paditur kane ushtruar nje kontroll ne fshatin Memelisht tek aktiviteti tregetar qe ushtronte paditesi Ramadan Seitllari ne kete fshat ne fushen e tregetise se ushqimeve dhe kane konstatuar se paditesi ushtronte aktivitet tregetar pa u pajisur me kase fiskale.

Me procesverbalin Nr.0028821, date 23.04.2012 inspektoret e pales se paditur kane vendosur denimin me gjobe te paditesit ne masen 100.000 leke per kryerjen e kundravajtjes administrative te mospajisjes me kase fiskale te parashikuar nga neni 122 i ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise".

Me njoftim vleresimin per detyrimet tatimore Nr.11125 Prot, date 23.05.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe eshte njoftuar paditesi per detyrimin e tij per te paguar gjoben ne masen 100.000 leke per kryerjen e kundravajtjes administrative te mospajisjes me kase fiskale.

Ne daten 24.05.2012 inspektoret e pales se paditur kane ushtruar perseri nje kontroll ne fshatin Memelisht tek aktiviteti tregetar qe ushtronte paditesi Ramadan Seitllari ne kete fshat ne fushen e tregetise se ushqimeve dhe kane konstatuar se paditesi perseri vazhdonte te ushtronte aktivitet tregetar pa u pajisur me kase fiskale.

Me procesverbalin Nr.0028829, date 24.05.2012 inspektoret e pales se paditur kane vendosur denimin me gjobe te paditesit ne masen 500.000 leke per kryerjen e kundravajtjes administrative te mospajisjes me kase fiskale te parashikuar nga neni 122 i ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 "Per Procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise".

Me njoftim vleresimin per detyrimet tatimore Nr.13313 Prot, date 19.06.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe eshte njoftuar paditesi per detyrimin e tij per te paguar gjoben ne masen 500.000 leke per kryerjen e kundravajtjes administrative te mospajisjes me kase fiskale.

Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore Nr.11125 Prot, date 23.05.2012 i Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe rezulton se i eshte njoftuar pales paditese nepermjet sherbimit postar ne daten 24.05.2012, sikurse rezuton nga kopje e librit e dorezimit te dokumentave postare te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.

Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore Nr.13313 Prot, date 19.06.2012 i Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe rezulton se i eshte njoftuar pales paditese nepermjet sherbimit postar ne daten 19.06.2012, sikurse rezuton nga kopja e librit e dorezimit te dokumentave postare te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.

Ne daten 16.10.2014 pala paditese ka paraqitur prane Drejtorise se Apelimit Tatimor kerkesen ankimore kunder njoftim vleresimeve per detyrimet tatimore Nr.11125 Prot, date 23.05.2012 dhe Nr.13313 Prot, date 19.06.2012 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.

Me vendimin Nr.26823/3 Prot, date 16.12.2014 te Drejtorise se Apelimit Tatimor eshte vendosur refuzimi i ankimit te pales paditese kunder njoftim vleresimeve tatimore te mesiperme per shkak se keto ankime jane depozituar jashte afatit ligjor 30 ditor ne Drejtorine e Apelimit Tatimor.

Pala paditese pretendon se akt konstatimet dhe procesverbalet e gjobave te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe jane akte te kundraligjshem dhe duhen shfuqizuar nga gjykata. Pala paditese gjate gjykimit pretendon se njoftim vleresimet per detyrime tatimore jane akte administrative te kundraligjshme dhe se pala paditese nuk e ka kryer kundravajtjen administrative te mospajisjes me kase fiskale, sepse nuk ka ushtruar aktivitet tregetar per tregetimin e ushqimeve. Pala paditese pretendon se ka kryer aktivitet tregetar ne fushen e transportit e udhetareve. Pala paditese pretendon se nuk i jane njoftuar nga pala e paditur njoftim vleresimet per detyrimet tatimore.

Pala e paditur prapeson duke pretenduar se ia ka njoftuar nepermjet shrbimit postar pales paditese njoftim vleresimet per detyrimet tatimore dhe se pala paditese e ka paraqitur ankimin e saj jashte afatit ligjor 30 ditor ne Drejtorine e Apelimit Tatimor dhe se ne te tilla rrethana gjykata duhet e

vendose mospranimin e padise, per shkak se paditesi nuk ka ezauruar rrugen administrative te ankimit.

Ne nenin 106 dhe 107 te ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne R.Shqiperise" thuhet:

Neni 106

Objekti i ankimit administrativ tatimor

1. Tatimpaguesi mund të ankimojë kundër çdo njoftim vlerësimi, çdo vendimi që ndikon në detyrimin e tij tatimor, çdo kërkesë për rimbursim ose lehtësim tatimor, ose çdo akti ekzekutiv të posaçëm tatimor, në lidhje me tatimpaguesin.

2. Ankimi bëhet me shkrim dhe në formën e parashikuar në zbatim të këtij ligji, me udhëzim të Ministrit të Financave.

3. Tatimpaguesi e dorëzon ankimin në drejtorinë e apelimit tatimor brenda 30 ditëve kalendarike nga data kur vlerësimi ose vendimi i administratës tatimore është marrë ose vlerësohet të jetë marrë nga tatimpaguesi.

4. Drejtoria e apelimit i dërgon një kopje të ankimit administratës tatimore, që ka nxjerrë vlerësimin tatimor ose vendimin, objekt të ankimit tatimor.

Neni 107

Pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi

1. Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që, bashkë me ankesën, të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

2. Shuma e pagueshme, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjithë gjokat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është subjekt i ankimit.

4. Akti administrativ, i lëshuar nga administrata tatimore dhe për të cilin nuk është ankimuar në rrugë administrative, nuk mund të ankimohej në rrugë gjyqësore".

Nga permbajtja e ketyre dispozitave ligjore dhe nga faktet e konstatuara sa me sipër rezulton se paditesi para se të drejtohej me padinë objekt gjykimi kesaj gjykate nuk ka ezauruar rrugen administrative te ankimit per te kundershtuar ne Drejtorine e Apelit Tatimor qofte akti konstatimet e dates 23.04.2012 dhe te dates 24.05.2012 dhe procesverbalet e

gjobave Nr.0028821 dhe Nr.0028829 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe, por nuk ka kundërshtuar gjithashtu ne rruge administrative brenda 30 diteve nga marrja dijëni as njoftim vleresimet per detyrimet tatimore perpara se ti drejtohej me padine objekt gjykimi kesaj gjykate.

Ne baze te nenit 16/1 te ligjit Nr.49/2012 padia ndaj veprimit administrativ mund te ngrihet vetem pas shterimit te ankimit administrativ.

Shterimi i ankimit administrativ eshte nje nder kushtet formale qe duhet te plotesoje padia ndaj veprimit administrativ.

Ne te tilla rrethana paditesi Ramadan Seitllari para se te paraqeste padine ne gjykate ku kundërshton akt konstatimet e dates 23.04.2012 dhe te dates 24.05.2012 si dhe procesverbalet e gjobave Nr.0028829 dhe Nr.0028821, duhet te ezauronte me pare ankimin administrativ duke i kundërshtuar keto akte ne Drejtorine e Apelimit Tatimor ne baze te ligjit Nr.9920/2008, nenet 106 dhe 107 te tij.

Ne te tilla rrethana gjykata ne baze te nenit 39/2 te ligjit Nr.49/2012, duhet te vendose mospranimin e padise se paditesit, per shkak se padia nuk ploteson kushtet formale te paraqitjes se saj, per shkak se nuk eshte ezauruar ankimi administrativ.

Lidhur me pretendimin e paditesit se nuk i jane njoftuar nga pala e paditur njoftim vleresimet per detyrimet tatimore, ky pretendim nuk gjen mbështetje ne prova, pasi gjate gjykimit rezultoi se keto njoftim vleresime I jane njoftuar rregullisht nepermjet sherbimit postar pales paditese nga pala e paditur.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 16/1, 39 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012
"Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe
Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative"


VENDOSI

1. Mospranimin e padise, per shkak se padia nuk ploteson kushtet formale te paraqitjes se saj.
2. Shpenzime gjyqesore jane ne ngarkim te pales paditese.

- Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën Administrative te Apelit Tirane brenda 15 diteve nga e nesermeja e shpalljes.
- U shpall sot me date 24.04.2015 ne Korçe.


SEKRETARE

MARINELA RUSHI



GJYOTAR

SOKOL IBI



Shpenzime gjyqesore:

1. Takse Pulle: 3.000 leke
Totali: 3.000 leke (te parapaguara nga paditesi).

Shenim: Vendimi ka marre forme te prere sot ne daten _____.

**KANCELAR
ALEKSANDER DINO**

B.